



Datë: 04.09.2025

Numër Protokolli: 5950/2025

A.nr.1132/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti, kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1132/2025 të datës 12.06.2025 të parashtruar nga ankuesja F.D nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Inspektorati Qendror i Punës, në çështjen juridike “*transferim si rezultat i ristrukturimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me shumicë votash, me datë 04.09.2025 mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës A.nr.1132/2025, e datës 12.06.2025, e parashtruar nga ankuesja F.D.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, F.D (*tani e tutje referuar: ankuesja*), me datë 12.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.R.IQP 1155/2025, të datës 22.05.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, për shkak të shkeljeve procedurale, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljeve ligjore dhe diskriminimit.

Kolegji i Këshillit, nga shqyrtimit i provave të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ lidhur me ankesën e ankueses, **sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës, rrjedhë se ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 23.04.2019 ka qenë në pozitën Zyrtare e Arkivit në Inspektoratin e Punës.

Tutje nga shkresat e lëndës rrjedhë së Kryeministri i Republikës së Kosovës ka miratuar Rregulloren (ZKM) Nr. 10/2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Ekzekutive të Inspektoratit Qendror të Punës. Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 29.11.2024 ka nxjerr Vendimin Nr. 2385/2024 për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit në Inspektoratin Qendror të Punës, ndërsa, ky i fundit, më datë 07.05.2025, ka përgatit raportin përfundimtar të punës me numër protokolli 942, duke propozuar që ankuesja të sistemohet në pozitën *Asistente Ekzekutive e Drejtorit Ekzekutiv*. Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më Vendimin me Nr.R.IQP.1155/2025, të datës 22.05.2025, ka transferuar ankuesen nga pozita aktuale Zyrtare e Arkivit 4 në pozitën *Asistente Ekzekutive e Drejtorit Ekzekutiv*.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me Nr.R.IQP.1155/2025, të datës 22.05.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pretendon se raporti i ristrukturimit është nxjerr me shkelje të rënda pasi që ka konstatuar se e njëjta plotëson kriteret të mbaj pozitën time e cila nuk është shuar duke mos marr fare për bazë dispozitat ligjore në fuqi. Kërkon që të miratohet ankesa dhe të anulohet vendimi i kontestuar.

Në procedurë të shqyrtimit të ankesës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.08.2025, ka pranuar Vendimin me numër protokolli 1663 të datës 13.08.2025 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme me të cilin ankuesja është ri caktuar në pozitën Zyrtare e Arkivit , ndërsa sipas pikës 3 të këtij vendimi është shfuqizuar Vendimi me Nr.R.IQP 1155/2025, i datës 22.05.2025, i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, ndërsa ankuesja më datë 26.08.2025, përmes emailit ka njoftuar se ka pranuar Vendimin me numër protokolli 1663 të datës 13.08.2025 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme duke njoftuar se është realizuar e drejta e saj dhe në të njëjtën kohë ka tërhequr ankesën e datës 26.08.2025.

Andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave, rrjedhimisht duke qenë se akti i kontestuar nga pala është shfuqizuar më datë 13.08.2025 nga organi që e ka nxjerrë të njëjtin përkatësisht Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe që pikërisht ky vendim ka qenë objekt i ankesës së datës 12.06.2025 dhe poashtu ankesa e njëjtë është tërhequr nga ankuesja, Kolegji erdhi në përfundim së objekti i ankesës është bërë i pamundur/kotë, kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku parashihet: “*1.Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë*”, si dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.1132/2025, të datës 12.06.2025.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda,A.nr.1132/2025, datë 04/09/2025.

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses F.D;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendror të Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.